

20212944634

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË MBROJTJES SOCIALE

Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes Sociale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20 dhe 163/21), në nenin 4, pas pikës 5) shtohet pika e re 5-a) si vijon:

“5-a) “Gjendja e çrregulluar shëndetësore” paraqet sëmundje (akute ose kronike), çrregullim, lëndim ose traumë. Gjendja e çrregulluar shëndetësore mund të përfshijë edhe rrethana të tjera, siç janë: stresi, anomali kongjenitale ose predispozita gjenetike dhe gjendje të tjera, të cilat ndikojnë në zhvillimin psikofizik të fëmijëve dhe të rinjve”.

Neni 2

Në nenin 29, paragrafi (7) ndryshohet si vijon:

“Me përjashtim të paragrafit (6) të këtij neni, i paaftë për punë llogaritet personi me pengesë mesatare, të rëndë ose të thellë intelektuale, me pengesë më të rëndë trupore, të vërtetuar me konstatim dhe mendim nga Shërbimi për vlerësim funksional i Institucionit Shëndetësor Publik – Shtëpia e Shëndetit Shkup, në pajtim me nenin 295, paragrafi (4) i këtij ligji”.

Neni 3

Në nenin 46, paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

“Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, personat sipas nenit 44, paragrafi (1) të këtij ligji, realizojnë të drejtën e kompensimit për shkak të pengesës, në bazë të konstatimit dhe mendimit nga Shërbimi për vlerësimin funksional i Institucionit Shëndetësor Publik, në pajtim me nenin 295, paragrafi (4) të këtij ligji”.

Neni 4

Në nenin 51, paragrafi (9) ndryshohet si vijon:

“Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, personi në moshë 26 vjeç, me aftësi të kufizuara mesatare, të rëndë ose të thellë intelektuale, dhe person me pengesë më të rëndë trupore, të vërtetuar me konstatim dhe mendim nga Shërbimi për vlerësim funksional në Institucionin Shëndetësor Publik – Shtëpia e Shëndetit Shkup, në pajtim me nenin 295, paragrafi (4) i këtij ligji dhe vendimit të qendrës për punë sociale”.

Neni 5

Në nenin 256, në paragrafin (1) fjalët “pengesë të rëndë dhe më të rëndë trupore” ndryshohen me fjalët “pengesë të vështirë, më të vështirë dhe shumë të vështirë trupore”.

Neni 6

Në nenin 260, në paragrafet (1) dhe (2), pas fjalës “vështirë” vendoset presje dhe shtohet fjala “më e vështirë”.

Neni 7

Neni 295 ndryshohet si vijon:

“Qendra e Punëve Sociale, në bazë të konstatimit dhe mendimit të organit profesional për vlerësim funksional në Institucionin Shëndetësor Publik – Shtëpia e Shëndetit Shkup, miraton aktvendim për llojin dhe shkallën e pengesës dhe e evidenton personin me pengesa në zhvillim.

Me vlerësimin funksional nga paragrafi (1) i këtij ligji, përcaktohen masat për mbështetje shtesë nga fusha e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve me gjendjen e çrregulluar shëndetësore deri në moshën 26 vjeçare.

Në procedurën pas ankesës kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, me të cilën kontestohet lloji i caktuar dhe shkalla e pengesës në konstatimin dhe mendimin e organit profesional për vlerësim funksional, Ministria kërkon përsëri konstatimin dhe mendimin e vlerësimit funksional, me çka kryhet vlerësimi i konstatimit dhe i mendimit të përgatitur nga një ekip profesional për koordinimin dhe përcjelljen e vlerësimit funksional në organin për vlerësim funksional.

Në bazë të vlerësimit të bërë të konstatimit dhe mendimit për vlerësim funksional të përgatitur nga një ekip profesional për vlerësim profesional, ekipi profesional për koordinimin dhe përcjelljen e zbatimit e vlerësimit funksional përgatit mendim me të cilën e vërteton konstatimin dhe mendimin për vlerësim funksional të përgatitur nga një ekip profesional për vlerësim funksional ose mendim për nevojën e përgatitjes së konstatimit të ri dhe mendim nga ekipi profesional për vlerësim funksional.

Shërbimi për vlerësim funksional në afat prej tetë ditësh nga dita e përgatitjes e dorëzon mendimin e ekipit profesional për koordinim dhe përcjellje të zbatimit të vlerësimit funksional, përkatësisht vlerësim funksional i ekipit profesional për vlerësim funksional, drejtuar Ministrisë.

Ministri, në pajtim me ministrin e Arsimit dhe të Shkencës dhe ministrin e Shëndetësisë, cakton rregullore për vlerësimin funksional, me të cilin përshkruhet mënyra e zbatimit të vlerësimit funksional, përcaktim më i afërt i masave për mbështetje shtesë nga fusha e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve me gjendje të çrregulluar shëndetësore deri në moshën 26 vjeç, përbërjen, profili profesional dhe mënyra e punës së ekipeve profesionale për vlerësim funksional, përbërja, profilet profesionale dhe mënyra e punës së ekipit profesional për koordinim dhe përcjellje të zbatimit të vlerësimit profesional, evidentimi i vlerësimeve dhe masave për mbështetje funksionale, të mendimit dhe të masave për mbështetje plotësuese, forma dhe përmbajtja e konstatimit dhe mendimi për vlerësimin funksional të përgatitur nga ekipi profesional për vlerësimin funksional, të mendimit të ekipit profesional për koordinim dhe përcjellje të zbatimit të vlerësimit funksional, njoftimi i qendrës për punë sociale dhe në përputhje të prindërit për zbatimin e vlerësimit funksional dhe shfrytëzimin e të dhënave personale”.

Neni 8

Në nenin 336, paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

“Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i autorizuar vërteton se është bërë shkelje nga nenet 350, 350-a, paragrafi (1), nënparagrafi 1), 3), 5) dhe 6) dhe paragrafi (2) nënparagrafi 1), 2) dhe 4), 350-b, 351, 352, 353 dhe 354 i këtij ligji, inspektori i autorizuar me aktvendim shqipton vërejtje dhe cakton afat ku subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i detyruar t’i shmangë parregullsitë dhe mungesat, të përcaktuara në procesverbal”.

Paragrafi (9) fshihet.

Paragrafi (10) bëhet paragrafi (9).

Neni 9

Akti nënligjor i parashikuar me këtë ligj, do të miratohet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Në sjelljen e aktit nënligjor nga paragrafi (1) i këtij ligji, organet kompetente japin konstatim dhe mendim për vlerësimin e llojit dhe shkallës së aftësisë së kufizuar dhe nevojat e veçanta të personave me aftësi të kufizuar në pajtim me rregulloret që kanë qenë të vlefshme nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 10

Procedurat e filluara për miratimin e aktvendimit për llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar, deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të kryhen sipas rregullave që kanë qenë të vlefshme deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Konstatimet dhe mendimet e lëshuara nga organi kompetent për vlerësimin e llojit dhe shkallës së aftësisë së kufizuar dhe nevojat e veçanta të personave me aftësi të kufizuara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të vlejné në procedurat për realizimin e të drejtave dhe shërbime nga fusha e mbrojtjes sociale në pajtim me ligjin.

Neni 11

Autorizohet Komisioni Juridiko-Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të konsoliduar të Ligjit të Mbrojtjes Sociale.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.